

**BEQIR META**

**QËNDRIMI I QEVERIVE GREKE NDAJ REZISTENCËS  
ANTIFASHISTE TË POPULLIT SHQIPTAR\***

Qëndrimi i qeverive greke ndaj rezistencës shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore përshkohet nga një bosht nationalist shoven dhe në qendër të politikës së tyre ka qenë objektivi i pandryshuar për të aneksuar Shqipërinë e Jugut. Ky objektivi mbeti i pandryshuar në të gjitha fazat e luftës ndonëse lëvizjet taktike të politikës greke u përshtatën me rrethanat e ndryshme në fazat e ndryshme të saj.

Në prill të vitit 1939, kur trysnia italiane arriti në një pikë të pakthyeshme dhe sulmi i armatosur dukej se ishte i afërt, A.Zogu u kërkoi ndihmë Greqisë dhe Jugosllavisë për organizimin e qëndresës. Por të dy fqinjët, duke ndjekur politikën e asnjësisë, nuk pranuan të angazhoheshin në asnjë lloj mënyre. Qeveria e Athinës e injoroi pushtimin e Shqipërisë nga italianët, madje, në letërkëmbimin e saj me Romën, nuk ngurroi të shprehte edhe tone mirëkuptimi e kënaqësie. Katër ditë pas pushtimit të Shqipërisë, më 11 prill, gjenerali Metaksas, nëpërmjet ministrit grek në Romë, i dërgoi Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë këtë mesazh: “Jam fare i bindur se asgjë nuk do të ndodhë në të ardhmen që ta prishë miqësinë tradicionale, që ekziston mes dy vendeve dhe që një epokë e re për zemërsie dhe bashkëpunimi paqësor mes nesh është duke filluar”<sup>1</sup>. Ndërsa disa muaj më vonë, ai e siguroi kontin Çiano se qeveria greke e ka njohur rolin e Italisë si një faktor me rëndësi të dorës së parë në Mesdhe dhe ka ndjekur vendosjen e marrëdhënieve me të vërtetë të përzemërta me Italinë, e cila ishte tani fqinja e saj, si në tokë, ashtu edhe në det<sup>2</sup>. Ndërkohë që Athina shprehte lumturinë për “fqinjën e re”, pa marrë parasysh se ishte pushtuar një komb fqinj, politikanët grekë nuk kishin pak dyshime se Italia, pas Shqipërisë, do të sulmonte edhe Greqinë.

Gjatë kohës që mbreti Zog qëndroi në Greqi, autoritetet greke nuk e lejuan atë të zhvillonte ndonjë veprimtari politike. Ky qëndrim pasqyrore jo vetëm synimin për të shprehur asnjësinë e qeverisë greke kundrejt pushtimit

---

\* Kumesë e mbajtur në Konferencën Shkencore “Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore”, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë, 26 nëntor 2009.

<sup>1</sup> *The Greek White Book*, London: 1942, dok.nr.28, f.30.

<sup>2</sup> *Po aty*, dok.nr.89, f.63.

të Shqipërisë, por edhe prirjen për të injoruar legjitimitetin e Mbretit të Shqipërisë dhe për të krijuar shkakun për ndërprerjen e vijueshmërisë së shtetit shqiptar për vënien në diskutim të njohjes ndërkombëtare të tij. Edhe Musolini mbeti i kënaqur nga ky qëndrim i Athinës. Më 9 prill ai udhëzonte të ngarkuarin me punë të Italisë në Athinë: “Vizitoni personalisht Metaksain dhe i thoni nga ana ime që i shpreh gjithë kënaqësinë time për qëndrimin e mbajtur nga Greqia kundrejt Zogut dhe e falënderoj për të gjitha masat e marra me qëllim që të pengojë manifestimet e Zogut, të cilat do të mund të hidhnin hije mbi raportet e miqësisë që bashkojnë të dy vendet”<sup>3</sup>.

Grekët u shqetësuan nga pushtimi i Shqipërisë, por ata vendosën të ndjekin një politikë luajale ndaj pushtuesve italianë, që kishin vendosur çizmen në kufirin greko-shqiptar. Në të vërtetë, Metaksai ishte i vendosur për t’i bërë qëndresë pushtimit të mundshëm italian, por kjo vendosmëri nuk dukej asgjëkundi në veprimet e qeverisë greke<sup>4</sup>. Pas prillit të vitit 1939, marrëdhëniet greko-italiane u përmirësuan gradualisht. Qëndrimin e qeverisë greke ndaj Italisë, ministri italian në Athinë e cilësoi “jo vetëm korrekt, por edhe miqësor”<sup>5</sup>.

Më 10 qershor 1940, Italia u deklaroi luftë aleatëve. Duke dashur të shmange çdo lloj acarimi me italianët, qeveria greke ndoqi një politikë hipokrite e të nënshtruar. Metaksai i tha, më 11 qershor, ministrit italian në Athinë se “kjo luftë do të qartësojë atmosferën dhe do të bëjë të mundshëm bashkëpunimin më intim midis Italisë dhe Greqisë”<sup>6</sup>. Ndërsa zëvendësministri i Jashtëm grek, Mavrudis, nënvizoi se Greqia e shikonte me kënaqësi të thellë afrimin e momentit, kur Italia do të zgjidhte çështjet që e kishin burimin në mosmarrëveshjet italo-franceze, sepse kështu paqja në Mesdhe do të ishte e siguruar për një kohë të gjatë, gjë që dëshirohej edhe prej popullit grek<sup>7</sup>. Në këto momente, përfaqësuesit e shtetit shqiptar, që ishin në mërgim, vepruan ndryshe. Ata e shtuan presionin ndaj Fuqive Perëndimore për të lejuar angazhimin në luftë kundër Italisë.

Një ditë pasi ushtria italiane sulmoi Greqinë, legata shqiptare në Londër, duke zbatuar udhëzimet e qeverisë shqiptare në mërgim, i ofroi ministrit të

<sup>3</sup> M. Çervi, *Storia della Guerra di Grecia*, Milano: “Sugar Editore”, 1965, f.17.

<sup>4</sup> Public Record Office, Foreign Office, Kew, London (më tej: FO) 371/23779. Ambasada në Athinë për FO, 9 prill 1939; J.S. Koliopoulos, *Greece and the British Connection, 1935-1941*, Oxford: 1977, f.110.

<sup>5</sup> E. Grazi, *Il principio della fine, L’impresa di Grecia*, Romë: 1945, f.45.

<sup>6</sup> *Documenti Diplomatici Italiani* (DDI) vol.V, Roma, 1965, dok.nr.3. Ministri në Athinë Grazi për ministrin e Punëve të Jashtme Çiano, Athinë, 11 qershor 1940.

<sup>7</sup> *Po aty*, dok.nr.103. Ministri në Athinë, Grazi, për ministrin e Punëve të Jashtme Çiano, Athinë, 22 qershor 1940.

Greqisë atje bashkëpunimin e Shqipërisë kundër armikut të përbashkët<sup>8</sup>. Por gjatë kësaj lufte grekët nuk i inkurajuan shqiptarët. Në qoftë se ata do të kishin bashkëpunuar me popullin shqiptar dhe me përfaqësuesit legjitimë të tij, pra, me qeverinë shqiptare në mërgim, i gjithë kombi shqiptar do të ishte ngritur në luftë, dhe pushtuesit italianë do ta kishin pasur shumë më të vështirë qëndrimin në Shqipëri. Por më e keqja do të vinte më vonë, kur qeveria dhe forcat politike greke do të ndiqnin me forcë fushatën për aneksimin e Shqipërisë së Jugut.

Një ofertë tjetër të ngjashme bëri qeveria shqiptare nëpërmjet legatës së saj në Ankara. Ajo i kërkoi qeverisë greke të lejonte formimin e një legjioni shqiptar, i cili do të luftonte kundër italianëve përkrah forcave greke me flamurin shqiptar. Ky legjion do të drejtohej nga oficerë shqiptarë, duke u vënë nën komandën e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Greke. Fillimisht qeveria e Metaksait e pranoi këtë propozim, por nuk u angazhua për armatosjen e vullnetarëve shqiptarë. Më 29 nëntor Shefi i Shtabit të Ushtrisë Greke, gjenerali Papagos, i tha ministrit britanik në Athinë, Palairt, se ai ishte kundër armatosjes së shqiptarëve, sepse këta mund të përdoreshin kundër ushtrisë greke<sup>9</sup>. Megjithatë, shqiptarët vërsuan në konsullatën shqiptare në Stamboll për t'u regjistruar në këtë legjion. Mirëpo kur ushtria greke filloi të avanconte në territorin shqiptar, qeveria greke e injoroi marrëveshjen e lartpërmendur. Duke parë reagimin negativ të britanikëve dhe të qeverisë greke, Komiteti Kombëtar për Çlirimin e Shqipërisë në Stamboll i drejtoi qeverisë britanike një memorandum në të cilën theksohej se Shqipëria, si viktimë e parë e agresionit të kryer nga Fuqitë e Boshitit, e vetmuar, ka vazhduar t'i rezistojë agresionit dhe meritonte një konsideratë më të madhe se kaq nga Aleatët. Aktualisht shqiptarët po u jepnin gjithë ndihmën e mundshme forcave anglo-greke duke besuar në çlirimin e atdheut të tyre. Kështu ata kërkonin: Publikimin e një deklaratë nga qeveria britanike në të cilën të theksohej se pas luftës Shqipëria do të rikthehej në gjendjen e saj si para 7 prillit 1939, ashtu siç do të bëhej për shtetet e tjera të pushtuara; qeveria britanike të lehtësonte krijimin e menjëhershëm të një qeverie kombëtare shqiptare. Këto kërkesa ishin të nevojshme për të inkurajuar shqiptarët që t'u jepnin ndihmën e tyre forcave anglo-greke, t'i krijohej besimi popullit shqiptar dhe t'i hiqeshin atij dyshimet që ishin krijuar prej shfaqjeve të qarta të rivendikimeve nga ana e Greqisë<sup>10</sup>.

<sup>8</sup> *United States National Archives, Department of State* (më tej: *USNA. DS*) 875. 01/405, Telegram i Përfaqësuesit të Legatës Shqiptare në Londër, dërguar Presidentit Rusvelt, 16 nëntor 1941.

<sup>9</sup> FO 371/24868. M. Palairt për FO, Athinë, 29 nëntor 1940.

<sup>10</sup> FO 371/29719. Letër e Komitetit Kombëtar për Çlirimin e Shqipërisë në Stamboll, (nënshkruar nga Mehmet Konica, Musa Juka, Hiqmet Delvina, Abdyl Sula, Branko Merxhani) dërguar kolonelit Stirling, 20 janar 1941.

Në të njëjtën kohë, një grup nacionalistësh me influencë, të cilët gjatë luftës italo-greke ishin mbledhur në Tiranë, i propozuan Komandantit të Armatës së 9-të Greke, që ishte dislokuar në rajonin e Gjirokastrës, gjeneralit Teholakoglou, organizimin e një revolte kundër italianëve në të gjithë Shqipërinë, në bashkëpunim me grekët, me kusht që Greqia të njihte integritetin territorial të Shqipërisë dhe pavarësinë e saj. Gjenerali grek u përgjigj se nuk ishte kompetent për këtë çështje, por premtoi se do t'ia përcillte këtë propozim qeverisë së tij në Athinë. Përgjigjja u prit gjatë por nuk erdhi asnjëherë. Edhe agjentët britanikë që vepronin në terren vunë re se shefat e ushtrisë greke dëshironin ta aneksonin rajonin dhe po bënë gjithçka që të parandalonin përpjekjet britanike për të nxitur revoltën e shqiptarëve kundër italianëve, kryesisht duke ndaluar armatosjen e tyre<sup>11</sup>.

Shumë kuptimplotë ishte edhe refuzimi i grekëve për të pranuar ndihmën e mbretit Zog. Zogu, i motivuar nga atdhetarizmi dhe nga mendimi se po të ndihmonte çështjen e Aleatëve ai do të rifitonte legjitimitetin në zgjidhjet që do të jepeshin pas luftës, u kishte ofruar Aleatëve ndihmën e tij që në korrik të vitit 1940. Britanikët në fillim kundërshtuan, sepse nuk donin ta nxisnin Italinë në ndonjë sulm kundër Greqisë ose Jugosllavisë. Por, pas sulmit italian kundër Greqisë, ata e rishqyrtuan vendimin e tyre. Zogu paraqiti një argument bindës. Ai sugjeroi se mund të jepte praktikisht një ndihmë të madhe, përderisa ai mund të mobilizonte 30.000 veta në Shqipërinë e Veriut. Për më tepër, ai argumentoi se kishte shumë mbështetje nga shqiptarët në Shtetet e Bashkuara, Bullgari, Egjipt dhe veçanërisht në koloninë e madhe shqiptare në Stamboll, ku mund të mobilizohej një forcë prej 14.000 vetash. Mbreti shqiptar paraqiti dhe një plan konkret. Ai kërkoi të shkonte në Greqi dhe atje të përpiquej ta organizonte këtë forcë, të hapte një front kundër italianëve dhe të organizonte një kryengritje të gjerë në të gjitha pjesët e Shqipërisë<sup>12</sup>. Ndonëse ishin mosbesues për shifrat e luftëtarëve që jepte Zogu, britanikëve u bëri përshtypje propozimi i tij dhe pranuan në parim idenë që ta përdornin Zogun sipas planit që ai sugjeronte. Por plani mbeti në letër, sepse u kundërshtua, në radhë të parë, nga qeveria greke.

Zogu bisedoi edhe me Ministrin Grek në Londër, Simopulos, të cilit i shpjegoi se ai mund të mbështetej në përkrahjen e shqiptarëve të Veriut, dhe që andej të godiste prapavijat italiane. Ai mendonte se pas ofensivës së suksesshme greke, italianët do të përforcoheshin në vijën Librazhd-Elbasan-Tepelenë, e cila ishte një fortesë natyrore e pakapërcyeshme. Mirëpo duke i goditur italianët nga veriu, ata do ta kishin shumë të vështirë t'i mbanin këto

<sup>11</sup> J. Amery, *Sons of the Eagle*, London: 1948, f.40.

<sup>12</sup> Bernd J. Fischer, *King Zog and the struggle for stability in Albania* (Boulder: East European Monographs, 1984), f.295; FO 371/24868/8270. Raport i Sër A. Royan, Londër, 8 nëntor 1940.

pozicione<sup>13</sup> F.O. e vlerësoi seriozisht këtë ofertë të dytë të A. Zogut, gjithashtu edhe Ministria e Luftës e pranoi si të mundshëm shkëlqen e italianëve nga Librazhdi dhe pikat e tjera të forta, po të veprohej ashtu siç kishte sugjeruar A.Zogu<sup>14</sup>. Kështu F.O. i kërkoi ambasadorit të vet në Greqi që të pyeste grekët, nëse e konsideronin të dobishëm dërgimin e Zogut në Shqipërinë e Veriut, për të drejtuar operacionin që ai kishte propozuar.

Në këtë rast qeveria greke do të sqarohet edhe njëherë se këtu nuk bëhej fjalë për ndonjë angazhim të qeverisë britanike apo asaj greke, as për rikthimin e Zogut në fron dhe as për ndonjë rregullim të statusit të ardhshëm të Shqipërisë. Këto gjëra do t'i bëheshin të qarta Mbretit, i cili do të shkonte në Shqipëri vetëm si një udhëheqës shqiptar i zoti, dhe jo si një ish-mbret, që njihej si i tillë nga disa qeveri aleate<sup>15</sup>.

Përgjigjja e gjeneral Metaksait, ndaj kërkesës britanike për ta angazhuar Zogun, ishte kategorikisht negative.

Pas kundërshtimit të vendosur grek, britanikët arritën në përfundimin se ata nuk mund t'ia impononin qeverisë greke bashkëpunimin me A. Zogun. Por Forin Ofisi ishte i bindur se Zogu mund të ishte i dobishëm deri diku. Kështu, u përpunua plani për ta dërguar Zogun në Kajro, afër fushës së operacioneve, dhe pastaj të bisedohej përsëri me palën greke. Por sërish autoritetet greke kundërshtuan. Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë greke njoftoi përfaqësuesin britanik në Athinë, Palairt, se ai e kundërshtonte organizimin e një kryengritjeje të përgjithshme në Shqipëri dhe se i vetmi veprim praktik në prapavijat italiane ishte lufta guerile<sup>16</sup>. Pra, filloi të dalë në shesh motivi i vërtetë i kundërshtimit të qeverisë greke për bashkëpunim me shqiptarët, i cili nuk ishte as morali e as mbështetja politike e Zogut në Shqipëri, por frika nga një lëvizje e organizuar e armatosur e shqiptarëve kundër italianëve, që do ta rendiste Shqipërinë në krahun e Fuqive Aleate, pas luftës, dhe do ta vështirësonte realizimin e aspiratës greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Më vonë, në shkurt të vitit 1941, qeveria greke eci më tutje në rrugën e kundërvënies ndaj organizimit të një qendrese të armatosur antifashiste në Shqipëri. Ajo arriti të bllokojë dhënien e një interviste të A. Zogut për BBC-në. Qeveria greke e vuri theksin në kundërshtimin e një pjese të intervistës së Zogut, ku ai deklaronte se shpresonte t'i shihte shqiptarët të lirë dhe të lumtur në kufijtë e vet ligjorë<sup>17</sup>.

<sup>13</sup> FO 371/24867, Shënime të P. Dixon, 6 dhjetor 1940; FO 371/24868, Shënime të P. Dixon, 26 nëntor 1940.

<sup>14</sup> FO 371/24868, Shënime të P.Dixon, 26 nëntor 1940.

<sup>15</sup> FO 371/24868, Telegram i FO. për M. Palairt në Athinë, 26 nëntor 1940.

<sup>16</sup> Bernd J. Fischer, *Albania and the italian invasion...*, f.100; FO 371/24868 / R 8924/6586/90. Sër Palairt për FO, Athinë, 14 dhjetor 1940.

<sup>17</sup> FO 371/29714 / R 1804/187/90. Palairt për FO, Athinë, 25 shkurt 1941.

Qëndrimin e pandryshueshëm të Athinës kundër organizimit të një qëndrese antifashiste shqiptare dhe arsytet e vërteta të kësaj politike, i bënë edhe më të qarta pengesat që i nxori qeveria greke një projekti tjetër të britanikëve për organizimin e një kryengritjeje në Shqipërinë e Veriut, pa e përfshirë Zogun në këtë lëvizje. Si figurë kryesore në këtë rast u zgjodh Gani Kryeziu, i cili do të lëvizte nga Kosova dhe do të pushtonte Kukësin, ku do të shpallte Qeverinë Kombëtare Shqiptare, e cila do të kryesohej prej tij. Kjo qeveri do të deklaronte qëndrimin armiqësor ndaj Italisë dhe qëndrimin miqësor ndaj Greqisë. Forin Ofisi, jo vetëm që e pranoi këtë skemë, me ndonjë rezervë të vogël, por përgatiti edhe një deklaratë për mbështetjen e Qeverisë Provizore. Kjo deklaratë përmbante edhe premtimin se Britania e Madhe do të ndihmonte për çlirimin e Shqipërisë<sup>18</sup>. F.O. mendonte se kjo deklaratë do të pranohej nga qeveria greke, përderisa ajo nuk thoshte asgjë më tepër, sesa deklarata e Metaksait, dhe përderisa qeveria greke kishte deklaruar se po merrte masa për transportimin e armëve dhe materialit luftarak nëpërmjet Greqisë tek gueriljet shqiptarë<sup>19</sup>. Shumë shpejt, zyrtarët e F.O., megjithëse i njihnin mirë aspiratat greke do të zhgënjeheshin nga qëndrimi i tyre. Ky plan iu dërgua ambasadës britanike në Athinë për të marrë pëlqimin e Metaksait. Por përgjigjja greke ishte dekurajuese. Gjenerali u shpreh se mbështeste vetëm bashkërendimin e veprimeve me banda të vogla dhe jo operacionet në shkallë të gjerë. Përfaqësuesi britanik, gjithashtu, njoftonte se Athina “ishite shumë kundërshtuese ndaj krijimit të ndonjë qeverie provizore në këtë moment”<sup>20</sup>. Pas refuzimit të Metaksait edhe ky propozim u la mënjanë. Qeveria greke nuk e dëshironte dhe nuk mund të jepte pëlqimin për një kryengritje me përmasa të tilla, sikundër propozonte Forin Ofisi, pasi ajo do të kishte pasoja edhe në fushën politike. Ajo do të legjitimonte një qeveri shqiptare dhe pavarësinë e Shqipërisë, si edhe njohjen e saj si palë në koalicionin antifashist. Pikërisht për këtë arsye, Athina parapëlqente dhe angazhohej të përkrahte vetëm veprimet e shkëputura guerile në prapavijat italiane.

Qeveria greke kundërshtoi edhe kërkesat e grupeve të mëdha të emigrantëve shqiptarë në Greqi për të luftuar kundër italianëve. Këtë e ka vënë në dukje në ditarin e tij drejtori i fondacionit “Near East” në Athinë, Laird Archer<sup>21</sup>. Si përfundim mund të themi se arsyeja më e rëndësishme se pse shqiptarët nuk morën pjesë masivisht në anën e grekëve, ishte refuzimi i

<sup>18</sup> B. Kondis, “A british attempt to organize a revolt in Northern Albania during the Greek-Italian War”, në botimin *Greece and the War in Balkans (1940-1941)*, Thesaloniki, 29 tetor - 1 nëntor 1990, f.118; FO 371/24867/8992. Forin Ofisi - Sekretariteti të Shtetit, 26 dhjetor 1940.

<sup>19</sup> FO 371/24867, Telegram i FO për M. Palairt në Athinë, 20 dhjetor 1940.

<sup>20</sup> B. Kondis, “A british attempt...”, f.118.

<sup>21</sup> B.J. Fischer, *Albania and the italian invasion...*, f.98.

vazhdueshëm i qeverisë greke për bashkëpunim. Në këtë përfundim kanë arritur edhe historianë të njohur perëndimorë<sup>22</sup>.

Grekët u treguan shumë të vendosur për të shmangur çdo përshtypje se shqiptarët dëshironin dhe kishin bërë përpjekje për t'i dëbuar italianët nga Shqipëria e Jugut. Kjo këmbëngulje deri në absurd lidhej me konsideratat për politikën e ardhshme, të cilat kishin dalë në plan të parë, madje duke i lejuar që të dëmtonin edhe përfitimet praktike ushtarake.

Pas pushtimit të Greqisë nga forcat e Boshtit, qeveria greke në mërgim filloi të formulojë dhe të shpallë hapur synimet e saj territoriale në drejtim të Shqipërisë. Gjatë viteve të luftës, qeveria greke në mërgim zhvilloi një aktivitet të ethshëm diplomatik dhe një propagandë intensive në opinionin publik perëndimor lidhur me çështjen shqiptare. Thelbi i kësaj propagande ishte paraqitja e Shqipërisë si një vend armik, që nuk meritonte asnjë lloj simpatie prej koalicionit antifashist. Ajo zhvilloi një fushatë sistematike për aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Ashtu, siç kishte ndodhur më parë, gjatë vitit 1940 deri në pranverë 1941, kur politika e Athinës kishte penguar mbështetjen e Forin Ofisit për organizimin e rezistencës antifashiste në Shqipëri, edhe presioni politik dhe diplomatik i qeverisë greke në mërgim, pa asnjë mëdyshje, ndikoi negativisht mbi qëndrimet e Londrës kundrejt rezistencës shqiptare në gjysmën e dytë të vitit 1941 dhe sidomos gjatë vitit 1942. Presioni grek bëri që Londra të vazhdonte ta mbante në karantinë Zogun edhe gjatë vitit 1942.

Presioni diplomatik i Greqisë vonoi për njëfarë kohe nxjerrjen e deklaratës britanike për Shqipërinë, e cila kishte kohë që po gatuhej e diskutohej, veçanërisht duke filluar nga vera e vitit 1942. Gjatë procesit të përgatitjes së deklaratës, qeveria britanike që nën presionin e vazhdueshëm të qeverisë greke, e cila kur e pa se nuk mund ta anulonte deklaratën e projektuar, kërkoi që ajo të afirmonte qartë pëlqimin e Britanisë së Madhe për aneksimin e Shqipërisë së Jugut nga Greqia pas luftime<sup>23</sup>. Në një notë greke thuhej se, në qoftë se deklarata britanike nuk do të njihete në mënyrë eksplicite të drejtat e Greqisë në "Epirin e Veriut", do të krijohej një përshtypje e hidhur në popullin grek dhe do të dobësohej rezistenca greke. Kjo humbje mund të zhvlerësonte avantazhet e pritshme të bashkëpunimit të një segmenti të popullit shqiptar me Aleatët. Në këtë mënyrë, qeveria greke po përpiqej ta shndërronte çështjen e pretendimeve të saj ndaj Shqipërisë së Jugut në një objekt tregtie, duke bërë biznes me Aleatët se ku ata mund të fitonin më shumë.

Deklarata e Edenit ngjalli shqetësim të madh te shqiptarët. Ky shqetësim u rrit më tej pas deklaratës së kryeministrit grek Cuderis, i cili foli hapur për pretendimet e Greqisë kundrejt Shqipërisë së Jugut. Që atëherë qeveria greke

<sup>22</sup> *Po aty.*

<sup>23</sup> FO 371/33108, Notë e ambasadorit grek Aghnides, dërguar A.Edenit, 14 dhjetor 1942.

në mërgim dhe përfaqësuesit e saj, Diamantopulos, në Uashington, dhe Aghinides, në Londër, e intensifikuan propagandën për këto pretendime. Rezultati ishte dëmtimi i bashkëpunimit midis grekëve e shqiptarëve dhe intensifikimi i përpjekjeve të nacionalistëve shqiptarë për t'u armatosur dhe për t'u përgatitur që ta mbronin vendin e tyre nga një sulm grek në të ardhmen. Ky ishte njëri ndër faktorët kryesorë që la gjurmë në strategjinë e forcave nacionaliste shqiptare gjatë luftës, e cila nuk jepte rezultatet pozitive që prisnin Aleatët. Por konsekuencat e deklaratës britanike të 17 dhjetorit 1942 dhe të këmbënguljes së qarqeve greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut kanë qenë edhe më të gjera.

Qeveria greke u përpoq të ushtronte presion edhe ndaj qeverisë amerikane por pa sukses. Siç dihet, deklarata amerikane ishte më pozitive se deklarata britanike, ajo afirmonte mbështetjen amerikane për restaurimin e pavarësisë së plotë të Shqipërisë dhe nuk shfaqte ndonjë rezervë për kufijtë e saj. Përmbajtja e kësaj deklarate e nxiti qeverinë greke t'i shprehte pakënaqësinë e saj Departamentit të Shtetit. Më 21 dhjetor 1942, përfaqësuesi grek në Uashington, Kimon P.Diamantopulos, i dërgoi një memorandum për këtë çështje qeverisë amerikane dhe verbalisht ia paraqiti pikëpamjet greke edhe Summer Wellesit<sup>24</sup>. Reagimi i Departamentit të Shtetit ndaj këtij veprimi të qeverisë greke ishte negativ. Nënshektari i shtetit Welles, pasi e lexoi memorandumun, i tha ambasadorit grek se "ishte sinqerisht i habitur nga mesazhi që ambasadori i kishte komunikuar, përderisa ato që kishte thënë sekretari i shtetit për Shqipërinë ishin po ato gjëra që qeveria amerikane kishte deklaruar më parë në lidhje me Greqinë dhe për shumë vende të tjera të pushtuara". Më tej, ai i tha ambasadorit grek se "njëri nga qëllimet e luftës së vendit tonë dhe të vendeve të tjera të Kombeve të Bashkuara është restaurimi i lirisë dhe i pavarësisë së vendeve të pushtuara dhe se sekretari i shtetit në deklaratën e tij nuk kishte bërë ndonjë referencë për kufijtë". Ai tha se nuk shihte ndonjë arsye të vlefshme që qeveria greke t'i kërkonte tani qeverisë së SHBA të bënte një deklaratë në lidhje me kufijtë grekë<sup>25</sup>.

Një pengesë për planet aneksioniste greke, në këto momente, përbënte emigracioni shqiptar, i cili përpiqej për njohjen e statusit legjitim të Shqipërisë si viktimë e agresionit fashist dhe si pjesëtare e koalicionit antifashist nga ana e Aleatëve. Pikërisht edhe në këtë plan, politika greke mendoi të jepte një goditje tjetër, duke aktivizuar për këtë qëllim armën e saj tradicionale, emigracionin grek në SHBA. U vu në lëvizje Lidhja Kombëtare Amerikane Pan-Epirote, e

<sup>24</sup> S.G. Xydis, *Greece and the Great Powers, 1944-1947*, Thessaloniki: 1963, f.24.

<sup>25</sup> *USNA.DS.F.W 875.01/459*. Memorandum bisede midis nënshektarit amerikan të shtetit, Welles dhe ambasadorit grek Cimon Diamantopulos, 21 dhjetor 1942.

cila, me një telegram tjetër dërguar C.Hullit<sup>26</sup>, synonte të bënte presion ndaj administratës amerikane që ajo të mos njihte asnjë qeveri shqiptare dhe asnjë komitet për çlirimin e Shqipërisë. Për t'i tërhequr vëmendjen zyrtarëve të Departamentit të Shtetit se nuk ia vlente mbështetja e emigracionit shqiptar, ajo e vinte theksin në lajmet mbi dështimin e përpjekjeve për të bashkuar dy fraksionet antagonistë shqiptarë në Shtetet e Bashkuara. Më tej, telegrami, duke u përpjekur të bindte Departamentin e Shtetit se nuk mund të kishte veprime parimore nga ana e udhëheqësve të emigracionit shqiptar, si F.Konica, F.Noli dhe K.Çekrezi, pohonte se ata më parë kishin qenë agjentë të italianëve dhe tani u kthyen pro Zogut pasi ky u dha dy të parëve më shumë para. Ndërsa K.Çekrezi nuk kishte përfituar nga ky shpërblim, prandaj ishte kundër njohjes së Ahmet Zogut si udhëheqës i emigracionit dhe i një qeverie shqiptare në mërgim. Por, në qoftë se Departamenti i Shtetit do t'i akordonte njohjen ndonjë komiteti për çlirimin e Shqipërisë, Lidhja Pan-Epirote kërkonte që ai “duhet të marrë në konsideratë faktet e rëndësishme dhe, kryesisht, faktin se të vetmit elementë në Shqipëri, me të vërtetë armiqësorë ndaj Italisë, janë epirotët grekë dhe se epirotët grekë e kombi grek mund ta keqinterpretimin një njohje të tillë të Komitetit “Shqipëria e Lirë” si një angazhim nga ana e Departamentit të Shtetit ndaj shqiptarëve në çështjen e lirive dhe të aspiratave të epirotëve grekë. Kështu, Federata Pan-Epirote i kërkonte qeverisë së SHBA të kishte kujdes që në përpjekjet e veta për të fituar mbështetjen e “dyshimtë” të krerëve shqiptarë, të mos armiqësonte “miqtë grekë” të persekutuar në Epir dhe në Greqi. Me qëllim që të shmangeshin rreziqe të tilla, ajo kërkonte që SHBA t'i jepnin garanci ambasadës greke në Uashington se të drejtat e “epirotëve” do të mbrohen. Vetëm kështu, “epirotët grekë” do të këshilloheshin nga ambasada greke që të mos shqetësoheshin nga ndonjë masë e Departamentit të Shtetit në përpjekje për të fituar mbështetjen e popullit shqiptar në luftën kundër fashizmit.

Rritja e rezistencës antifashiste në Shqipëri bëri që qeveria greke në mërgim ta kthente vështrimin nga ngjarjet që po zhvilloheshin atje. Synimi i saj ishte që të kundërvepronte ndaj autoritetit të ri politik, që do të dilte nga rritja e kësaj lufte. Në pranverë të vitit 1943 u dukën qartë shenjat e kësaj rritjeje të rezistencës antifashiste shqiptare dhe, tashmë, edhe fundi i pushtimit italian dukej më i afërt. Në këtë kohë po vëreheshin edhe tendencat e bashkëpunimit të forcave antifashiste brenda vendit.<sup>27</sup> Pikërisht në këtë kohë vjen edhe reagimi i qeverisë greke ndaj gjendjes në Shqipëri, i cili kishte një sërë elementesh të

<sup>26</sup> *Po aty*, F.W 875.01/435, Telegram i Lidhjes Kombëtare Amerikane Pan-Epirote, nënshkruar nga presidenti i saj Basil Moulas dhe sekretari i përgjithshëm Constantine S.Demas, dërguar C.Hullit, 10 dhjetor 1942.

<sup>27</sup> Muharrem Dezhgiu, “Përpjekjet e forcave politike shqiptare për bashkim gjatë Luftës II Botërore”, në *Studime historike*, nr.1-2, 2000.

reja, që, mesa duket, lidheshin me këtë situatë të re. Synimi kryesor, tashmë, ishte negativimi i rezistencës shqiptare kundër fashizmit, e cila po rritej kundër dëshirës së grekëve. Në një Aide-Memoire të kryeministrit grek drejtuar qeverisë britanike<sup>28</sup> shprehej shqetësimi për situatën e krijuar në Shqipëri dhe flitej për “një seri krimesh” që ishin kryer kundër “popullsisë greke” në “Epirin e Veriut” pas vendimeve të marra në dy takime të të ashtuquajturve patriotë shqiptarë”. Nota greke, për ilustrim përmendte djegien e disa shtëpive në fshatin Jorgucat. Duke përfituar nga koniunktura e turbullt e pushtimit italian, dhe nga mungesa e burimeve informative të Aleatëve nga terreni, që do të mund t’i verifikonin ngjarjet, qeveria greke i zmadhonte artificialisht dhe qëllimisht këto akuza. Ajo njoftonte Londrën se këto veprime mund të çonin në përleshje të përgjakshme midis gueriljeve greke që vepronin në rajonin kufitar, dhe “bandave” shqiptare. Për më tepër, qeveria greke përpiqej t’u vishte forcave të rezistencës, që vepronin në Shqipëri, qyrkun e bashkëpunëtorëve të qeverisë kuislinge shqiptare dhe të pushtuesve italianë. “Krimet” e supozuara, që kishin kryer gueriljet shqiptare kundër “elementëve grekë në Shqipërinë e Jugut, ajo i cilësonte si vazhdimin e masave të tjera, që ishin marrë nga qeveria e Tiranës për minimin e pozitës së komunitetit grek në “Epirin e Veriut”. Në këto masa ajo fuste edhe emërimin e peshkopit Visarion Xhuvani, të cilin e quante “një provokacion për elementin ortodoks grek” në Shqipëri, si dhe shpalljen e krijimit të një ushtrie e xhandarmërie kombëtare shqiptare në shkurt të vitit 1943 nga kryeministri shqiptar, për arsye se ajo ishte e përbërë vetëm nga shqiptarë. Qeveria greke arrinte në përfundimin absurd se në Shqipëri po nxitej dhe fuqizohej një lëvizje antihelenike. Ajo i kërkonte qeverisë britanike që ta merrte seriozisht këtë informacion dhe “t’u bënte një paralajmërim shqiptarëve, se politika që ata po ndjekin do të dënohet nga Aleatët si armiqësore dhe kundër parimeve të tyre”. Demarshi i qeverisë greke nuk u gëlltit i tëri nga Londra, por sidoqoftë arriti të fuste në axhendën e Forin Ofisit një problem, që nuk ekzistonte realisht. Në këto momente, ndonëse informacioni që kishin britanikët ishte i pakët, ai provonte se midis shqiptarëve dhe minoritetit grek ekzistonin marrëdhënie të mira bashkëpunimi

Do të duheshin edhe disa kohë që misionet britanike dhe amerikane ta hetonin situatën në Shqipëri dhe të zbulonin karakterin tendencioz dhe falsitetin e këtyre pretendimeve. Kishte një lidhje, që dukej qartë, midis kësaj fushate të grekëve për të zhvleftësuar rezistencën shqiptare dhe një përkujtese tjetër të kryeministrit Cuderos dërguar Edenit, më 1 mars 1943, ku ai kishte shfaqur “shqetësimin e madh grek për të forcuar kufirin verior të Greqisë, veçanërisht në drejtim të Bullgarisë dhe Shqipërisë<sup>29</sup>. Përpjekjet e saj për të diskredituar

<sup>28</sup> FO 371/37147, Aide - Memoire e kryeministrit grek, 11 maj 1943.

<sup>29</sup> FO 371/43567, Raport i Departamentit Studimor të Forin Ofisit për kufijtë e Shqipërisë, 30 qershor 1944.

Lëvizjen Antifashiste Shqiptare, si një lëvizje me tendenca shoviniste, qeveria greke në emigracion i shtriu edhe në drejtim të Uashingtonit. Po në maj të vitit 1943, ambasada mbretërore e Greqisë në Uashington, në një memorandum drejtuar Departamentit të Shtetit, vinte në dukje se “informacionet përfundimtare tregojnë se të ashtuquajturit patriotë shqiptarë po shpërthejnë një fushatë terrori kundër popullsisë greke të “Epirit të Veriut”. Dhuna po ushtrohet në forma të ndryshme, me qëllim që të detyrohen grekët të ndryshojnë ndjenjat e tyre kombëtare”<sup>30</sup>. Më tej, administratës amerikane i paraqiteshin po ato argumente dhe i bëheshin po ato kërkesa, që i ishin bërë Londrës disa ditë më parë.

Në përpjekjet e saj për të penguar afirmimin ndërkombëtar të Lëvizjes antifashiste shqiptare, qeveria greke ndeshi edhe një pengesë tjetër dhe pikërisht shërbimin e BBC-së, i cili po përmendte gjithnjë e më shpesh aktivitetet e luftëtarëve shqiptarë. Në fund të qershorit 1943, qeveria greke denoncoi në Forin Ofis shërbimin e BBC-së në greqisht, sepse më 14 qershor kishte përmendur në mënyrë të veçantë rolin që po luanin gueriljet shqiptare, të cilët po i çelnin rrugën “zbarkimit të trupave Aleate në Ballkan”<sup>31</sup> Gjatë gjithë verës së vitit 1943, qeveria greke përsëriti protestat, si ndaj akteve që po kryenin gueriljet shqiptare në Shqipërinë e Jugut, ashtu dhe ndaj shërbimit të BBC-së, që transmetonte informacione për luftën antifashiste në Shqipëri. Në qershor ajo vijoi të shtjellonte akuzat e saj kundër gueriljeve shqiptare, duke pretenduar se “italianët së fundi kanë shtyrë gueriljet shqiptare në “Epirin e Veriut”, me qëllim që të vazhdojnë persekutimin e grupeve të gueriljeve tona” (greke – B.M.). Gjithashtu, pohohej se nacionalistët shqiptarë po merrnin masa shtrënguese kundër banorëve të Artës (Narta – B.M.), një fshat i vogël afër Vlorës, me qëllim që t’i detyronin ata të merrnin pjesë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Kështu qeveria greke i përsëriste edhe njëherë kërkesën qeverisë britanike që të paralajmëronte gueriljet shqiptare të ndërprisnin aktivitetet e frymëzuara nga urrejta raciale”<sup>32</sup>

Pra, siç duket, kishte një insistim të veçantë të qeverisë greke në emigracion që populli grek të mos kishte asnjë informacion për luftën antifashiste që po zhvillohej në Shqipëri. Dhe, me siguri, ky qëndrim lidhej me skemën që kishte përpunuar, tashmë, politika greke për ta paraqitur Shqipërinë si një vend aleat të Boshtit, si shkaktaren dhe përgjegjësen për fatkeqësitë që

<sup>30</sup> *The Greek Minority in Albania - A Documentary Record (1921-1993)*, botuar nga Basil Kondis, Eleftheria Manda, Thessaloniki: 1994, f.112, Memorandum i Ambasadës Mbretërore Greke në SHBA, për Departamentin e Shtetit; NADS, 767,75/20, Uashington, 21 maj 1943.

<sup>31</sup> FO 371/37147, Aide-Memoire e qeverisë greke dërguar Forin Ofisit, 20 qershor 1943.

<sup>32</sup> Po aty.

kishte pësuar populli grek gjatë luftës dhe për të justifikuar, kështu, pretendimin e saj për ndëshkimin e Shqipërisë, duke i shkëputur pjesën jugore të territorit të saj. Kështu, ajo mendonte se në të ardhmen do ta kishte më të lehtë ta angazhonte popullin grek në ndonjë aksion ushtarak ose politik për t'ia arritur këtij qëllimi. Edhe gjatë muajve korrik-gusht qeveria greke vazhdoi të përgjonte dhe të shikonte me lente zmadhuese çdo informacion të BBC-së për luftën kundër italianëve në Shqipëri. Gjatë korrikut ajo i dërgoi dy Aide-Memoire të tjera ambasadës britanike në Kajro<sup>33</sup>. Por megjithëkëto insistime, informacionet që kishin anglezët nga terreni nuk po i vërtetonin akuzat mbi persekutimin e grekëve në Shqipërinë e Jugut<sup>34</sup>.

Kur ishte në kulmin e fushatës për diskreditimin e lëvizjes së rezistencës në Shqipëri, qeveria greke i kërkoi Edenit, në mënyrë specifike, aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Ambasadori grek Aghnides i deklaroi atij se qeveria greke “është e obliguar të paraqesë pretendimet e saj të drejta ndaj Mbretërisë së Italisë. Këto janë Ishujt e Egjeut dhe “Epiri i Veriut”<sup>35</sup>. Që nga kjo kohë qeveria greke po jepte sinjalet se ajo e konsideronte veten në gjendje lufte me Shqipërinë, kështu që eventualisht do të kërkohej nënshkrimi i një traktati paqesje me të. Më 15 gusht, ambasadori grek në Uashington i dorëzoi Eduard R.Stettiniusit një memorandum për kushtet e paqes, që duhej t'i imponoheshin Shqipërisë. Ambasadori amerikan në Athinë, Macveagh, gjithashtu, u njoftua për këtë demarsh<sup>36</sup>. Sipas një letre të Filip Dragumisit, dërguar S.G.Xydisit më vonë, më 31 gusht 1960, rezulton se orientimet për ngritjen e çështjes së gjendjes së luftës midis Greqisë e Shqipërisë i kishte dhënë qeveria e Papandreut, në Kajro, në korrik-gusht të vitit 1944<sup>37</sup>.

Në të njëjtën kohë, qeveria greke iu rikthye edhe një herë akuzave të vjetra të pranverës dhe verës së vitit 1943 mbi “aktivitetet kriminale të bandave shqiptare”, megjithëse tani, këto akuza ishin përgënjeshtuar nga burimet britanike. “Persekutimin” e banorëve “grekë” në Shqipërinë e Jugut, tani ajo filloi t'ia ngarkonte forcave të UNÇSH. Një akuzë e tillë u bë nga MPJ e Greqisë në Kajro, me anë të një përkujtese që iu dorëzua më 21 gusht 1944, përfaqësuesit britanik Leeper. Kjo akuzë e grekëve i shtyu britanikët të bënin hetime. Më 18 shtator O.G. Sargent iu përgjigj ambasadorit grek se, në

<sup>33</sup> FO 371/37147, Informacion i ambasadës britanike akredituar pranë qeverisë greke në Kajro, dërguar Forin Ofisit, 19 korrik 1943.

<sup>34</sup> FO 371/37147/R 5616/3972/90. Projekt-telegram i P.Dixon për Miss Barker, 5 korrik 1943.

<sup>35</sup> FO 371/43567, Raport i Departamentit të Studimeve të Forin Ofisit mbi kufijtë e Shqipërisë, 30 qershor 1944.

<sup>36</sup> S.G. Xydis, *Greece and the Great Powers...*, f.42, 566. (Autori u referohet dokumenteve të Dragumisit).

<sup>37</sup> *Po aty*, f.567.

kundërshtim me informacionin që përmbante letra e qeverisë greke, të dhënat tregonin se gueriljet shqiptare i kanë siguruar vetes një famë të lavdërueshme për kundërshtimin aktiv, si të italianëve, ashtu dhe të gjermanëve”. Ai hidhte poshtë kërkesën e qeverisë greke për t’u ndërprerë furnizimet me armë këtyre gueriljeve<sup>38</sup>. Sipas një raporti të Forcës 399 në Bari, me datë 26 shtator 1944 ata kishin arritur në përfundimin se akuza greke nuk ishte substanciale<sup>39</sup>. Ne duhet të nënvizojmë fort se, në kundërshtim me akuzat greke, partizanët e Shqipërisë së Jugut janë një forcë e organizuar dhe kanë luajtur një rol aktiv dhe të rëndësishëm në dëmtimin e trupave dhe komunikacioneve të gjermanëve<sup>40</sup>.

Qeveria greke shkoi dhe më tutje dhe i paraqiti qeverisë së SHBA ankesën se agjencitë Aleate në Bari po i toleronin këto “banda” të inkriminuara. Sipas saj, “këto banda të rekrutuara midis fiseve fanatike shqiptare, të cilat asnjëherë nuk kanë luftuar kundër armikut seriozisht, janë përqendruar në “Epirin e Veriut”, ku synojnë të dëbojnë popullsinë greke të rajonit. Qeveria greke nuk mund të kuptojë përse këto veprime shqiptare të organizuara nga Aleatët po zhvillohen ekskluzivisht në pjesët greke të Shqipërisë dhe nuk po shtrihen krejtësisht në Shqipërinë Qendrore, ku kalojnë rrugët strategjike të Shqipërisë në drejtim të Maqedonisë”<sup>41</sup>. Me sa duket grekët i ngatërronin shqiptarët me veten e tyre kur mendonin për politika dhe projekte të spatrimin etnik.

Akuzat e trilluara greke shpejt do të nxirrnin në pah edhe synimin e tyre. Kur luftës po i vinte fundi dhe, pikërisht, më 15 gusht 1944, qeveria greke i kërkoi Departamentit të Shtetit që të miratonte okupimin e Shqipërisë së Jugut nga trupat greke deri në lumin Shkumbin. Kjo orvajtje e saj vihet në dukje në një dokument të Kabinetit të Luftës së SHBA.<sup>42</sup>

Me afrimin e fundit të luftës, propaganda greke për aneksimin e Shqipërisë së Jugut u intensifikua. ministri grek i shtypit foli për këtë gjë në radion e Kajros. Por tani kjo propagandë u shoqërua edhe me lëvizje ushtarake. Në shtator, forcat e Zervës kaluan kufirin shqiptar në një inkursion të armatosur. Ky veprim bëri që E. Hoxha të kërcënonte me hakmarrje.

\* \* \* \* \*

<sup>38</sup> FO 371/43551, Përgjigje e O.G.Sargent për ambasadorin grek, 18 shtator 1944.

<sup>39</sup> FO 371/43553/R15933, Letër e T.Boxshall për D.Laskey në Forin Ofis, 3 tetor 1944.

<sup>40</sup> FO 371/43553, Raport i shtabit të Forcës 399 CMF, dërguar shtabit të Forcës 133, 26 shtator 1944.

<sup>41</sup> FO 371/43553, Mesazh i AFHQ për BAFD 788, 18 shtator 1944.

<sup>42</sup> FO 371/43554.

Popujt shqiptar dhe grek ishin viktima të një lufte të paprovokuar prej tyre. Për këtë arsye, simpatia dhe përkrahja reciproke e tyre do të kishte qenë jo vetëm e dobishme për momentet e luftës, por edhe një bazë e shëndoshë për zhvillimin e marrëdhënieve miqësore të fqinjësisë së mirë në të ardhmen. Politika nacionaliste ekstremiste dhe jorealiste e qeverisë dhe e forcave të djathta greke u bënë pengesa kryesore për arritjen e mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit. Pothuajse e gjithë klasa politike greke e periudhës së luftës, me përjashtim të komunistëve, e shfrytëzuan oportunitetin e pushtimit italian të Shqipërisë, si pikënisjen e një fushate të re shumë të gjatë, shumë kokëfortë dhe shumë të rrezikshme për aneksimin e Shqipërisë së Jugut. Fillimet e kësaj politike nisin zyrtarisht me shpalljen e ligjit të gjendjes së luftës në nëntor të vitit 1940 nga parlamenti grek, kundër Shqipërisë së pushtuar prej Italisë.

Greqia, me insistimin e saj, arriti të ndikojë mbi politikën e Fuqive Perëndimore, për të mos përkrahur organizimin e rezistencës së popullit shqiptar gjatë gjithë periudhës së pushtimit dhe për të bllokuar njohjen e qeverisë së ligjshme shqiptare në ekzil. Në këtë mënyrë ajo ndikoi drejtpërdrejt dhe fuqimisht që populli shqiptar të mbetej pa një përfaqësi zyrtare jashtë vendit, e cila duhej të mbronte interesat e tij, dhe të përpiqej për organizimin e rezistencës antifashiste. Duke plotësuar ose toleruar kërkesat greke, Aleatët e vunë Shqipërinë në kondita inferiore për mbrojtjen dhe propagandimin e të drejtave të veta kombëtare, në raport me fqinjët ballkanikë, qeveritë në mërgim të të cilëve u njohën dhe u trajtuan si partnerë prej tyre. Ky qëndrim jo vetëm që ka qenë një padrejtësi dhe një veprim shumë amoral e i rrezikshëm në marrëdhëniet ndërkombëtare, por ai e cenoi rëndë pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë, rrezikoi të ardhmen, pengoi ndjeshëm dëshirën dhe realizimin e vullnetit të popullit shqiptar për t'i rezistuar agresionit. Gjithashtu, tërthorazi, ai ndikoi për krijimin e një situatë anarkike të zhvillimeve politike në Shqipëri. Lëshimi që i bënë Greqisë, aleatët, gjatë kësaj kohe, duke mos ndihmuar organizimin dhe mbështetjen ndërkombëtare të rezistencës shqiptare dhe duke mos njohur qeverinë legjitime shqiptare, i dha shtytje dhe nderzi fushatën aneksioniste të Greqisë ndaj Shqipërisë. Për rrjedhojë, këtu e ka origjinën edhe rindezja e armiqësive greko-shqiptare, të cilat do të vazhdonin shumë gjatë, për dekada të tëra.